

# **Ndryshimi i Kodit Penal: anti evropian dhe i dëmshëm në luftën kundër korrupsionit**



# Përmbajtja

<b>HYRJE</b>	3
<b>NDIKIMI I NDRYSHIMIT TË NENEVE 353, 353-V DHE 394 NË LUFTIMIN E KRIMIT DHE TË KORRUPSIONIT</b>	4
<b>SA JANË KËTO NDRYSHIME NË PËRPUTHJE ME LEGJISLACIONIN EVROPIAN ?</b>	6
Ndëshkimi i keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar dhe i përvetësimit të pronës publike	6
Parashkrimi i keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar dhe i përvetësimit të pronës publike	8
<b>KONKLuzion</b>	9

## HYRJE

Kodi i ri penal i Maqedonisë së Veriut ka hyrë në fuqi më 14 shtator, pas një procedure të kontestuar dhe miratim në mënyrë eksprese nga Kuvendi, me flamur evropian.

Ndryshimi i tre neneve veçanërisht, u kritikua ashpër nga opozita, shoqëria civile dhe aleatët e Maqedonisë së Veriut: keqpërdorimi i pozitës dhe autoritetit zyrtar (neni 353), të punuarit e pa ndërgjegjshëm në shërbim (neni 353-v) dhe bashkëveprimi kriminal (neni 394).

Këto ndryshime vijnë me pasoja serioze në luftimin e krimit dhe të korrupsionit:

1. Ulja e dënimeve maksimale të parapara për tre krimet në fjalë;
2. Vjetërsimi më i shpejtë i lëndëve që ndërlidhen me këto tre krime;
3. Shfuqizimi i dispozitës penale që ka të bëjë me shpërdorimin e pozitës dhe kompetencave zyrtare gjatë prokurimit publik ose në dëm të mjeteve publike.

# NDIKIMI I NDRYSHIMIT TË NENEVE 353, 353-V DHE 394 NË LUFTIMIN E KRIMIT DHE TË KORRUPSIONIT


Parashkrimi më i shpejtë i krimeve vjen si pasojë e uljes së dënimeve të parapara për krime të caktuara. Prashkrimi i krimeve rregullohet përmes nenit 96-n të kodit penal të Maqedonisë së Veriut. Ky nen parasheh se krimi vjetërsohet si vijon: tre vjet pas kryerjes së një krimi që dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet; pesë vjet për krimet që dënohen me burgim më shumë se tre vjet dhe ; dhjetë për krimet që dënohen me më shumë se pesë vjet burg.

- Sa i përket nenit 353 rreth keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar, dënimet janë ulur nga “së paku 5 vjet” burg sa ishin në “1 deri në 5 vjet” burg. Me këtë ndryshim, vjetërsimi i krimit të ulet nga 10 sa ishte, në 5 vjet tani.
- Në nenin 353-v, është tërhequr dënimi maksimal prej 5 vjet dhe i njëjtë është çvendosur në kuadër të nenit 353. Nenin 353-v tani nuk parasheh dënim më të lartë se 3 vjet burg, gjë që ndikon që krimet e këtij lloji të vjetërsohen për 3 vjet, krahasuar me 5 vjet më parë.
- Sa i përket bashkëveprimit kriminal, ulja e dënimeve është edhe më e madhe dhe ndikimi në parashkrimin e lëndëve, edhe më i dëmshëm. Themeluesit e grupimeve kriminale do të dënohen me më së shumti deri në 5 vjet burg (10 më parë), ndërsa anëtarët deri në 2 vjet (5 më parë). Rrjedhimisht, parashkrimi i krimeve ulet respektivisht nga 10 në 3 vjet dhe nga 5 në 3 vjet.

Pra, në përgjithësi, ndryshimi i kodit penal do të thotë se dënimet në këto lëndë penale do të jenë më të vogla dhe shumë krime do të parashkruhen më shpejt, duke pamundësuar ndekjen penale ose vuajtjen e dënimit.


Sipas raportit të fundit vjetor të Prokurorisë Publike së RMV-së për punën e prokurorive publike, vetëm në vitin 2021 dhe 2022, 2,612 persona janë paditur për keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar (neni 353). Aktakuza janë ngritur në 351 raste në të cilët janë nxjerrë 228 aktgjykime (apo 8.7% e lëndëve).

### Rastet e keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar (neni 353) 2021-2022



Në bazë të nenit 353-v (të punuarit e pandërgjegjshëm në shërbim), në periudhën 2021-2022, janë paditur 385 persona dhe janë ngritur 41 aktakuza, nga të cilat për 36 është shpallur aktgjykim (apo 9.4% e lëndëve).

### Rastet e të punuarit e pandërgjegjshëm në shërbim (neni 353-v) 2021-2022



Nëse këtyre numrave u shtohen edhe qindra, ndoshta mijëra raste më të vjetra të pazgjydhura në sistemin e drejtësisë së vendit, kuptohet se ndikimi i ndryshimit të kodit penal në luftën kundër korrupsionit do të jetë jashtëzakonisht i dëmshëm qysh nga hyrja e tij në fuqi dhe për dekada me radhë. Ekziston rreziku se pas këtyre ndryshimeve, pandëshkueshmëria do të kthehet në normë në një sistem edhe ashtu jo efektiv në ndjekjen e krimit dhe korrupsionit.

## SA JANË KËTO NDRYSHIME NË PËRPTHJE ME LEGJISLACIONIN EVROPIAN ?

Skandali më i madh i këtyre ndryshimeve qëndron në abuzimin e procedurës së flamurit evropian, që mundëson procedurë të shkurtuar për ligjet që synojnë përafrimin e legjislacionit vendor me të drejtën evropiane.

Përdorimi i flamurit evropian është arsyetuar nga qeveria por në esencë, ndryshimi i neneve 353, 353-v dhe 394 është anti evropian dhe në kundërshtim me përpjekjet e institucioneve të BE-së për të luftuar korrupsionin.

Më 3 maj 2023, Komisioni Evropian (KE) ka propozuar një direktivë të re evropiane në fushën e luftës kundër korrupsionit, me synimin që të harmonizohet parandalimi dhe sanksionimi i korrupsionit në vendet anëtare të BE-së. Direktiva tanimë është në procedurën legjislative evropiane dhe pritet të miratohet së shpejti. Ajo shoqërohet edhe me një inventar të gjendjes aktuale të luftimit të korrupsionit në vendet anëtare të BE-së, veçanërisht në rrafshin ligjor.

### Ndëshkimi i keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar dhe i përvetësimit të pronës publike

Sipas KE-së, keqpërdorimi i pozitës dhe autoritetit zyrtar dënohet mesatarisht me 6 vjet burg në shtetet anëtare të BE-së. Me direktivën e re, KE propozon që dënimi të jetë së paku 5 vjet në të gjitha shtetet anëtare.

Dënimi prej 1 deri në 5 vjet i preparë me kodin e ri penal të Maqedonisë së Veriut shkon kundër praktikës evropiane dhe direktivës së re për luftimin e korrupsionit.

Sipas KE-së, nuk ka asnjë shtet anëtar të BE-së ku nuk definohet me ligj përvetësimi, shpërdorimi dhe devijimi tjetër i pronës nga zyrtarët publik, edhe pse përkufizimet dallojnë nga shteti në shtet. Kjo demanton deklaratat e zyrtarëve qeveritarë të

Maqedonisë së Veriut, veçanërisht e zëvendës Kryeministrit Grubi, se krimi i përvetësimit apo shpërdorimit të burimeve publike nuk kriminalizohet në disa shtete anëtare të BE-së.

Sipas KE-së, përvetësimi, shpërdorimi dhe devijimi tjetër i pronës nga një zyrtar publik, dënohet mesatarisht me 8 vjet burg në BE. Me direktivën e re, KE propozon që pragu i dënimit të jetë së paku 5 vjet në të gjitha shtetet anëtare.

Kodi i ri penal i Maqedonisë së Veriut përsëri është në shpërputhje flagrante me praktikën evropiane dhe direktivën e re për luftimin e korrupsionit, meqë përvetësimi i mjeteve publike është hequr nga neni 353.

## Ndëshkimi i keqpërdorimit të autoritetit zyrtar dhe përvetësimit të pronës publike BE vs. Maqedoni e Veriut

KRIMI	DËNIMI MESATAR ME BURG I PARAPARË ME LIGJ NË SHTETET ANËTARE TË BE-SË	DËNIMI ME BURG SIPAS DIREKTIVËS EVROPIANE PËR LUFTIMIN E KORRUPSIONIT	DËNIMI SIPAS KODIT PENAL TË RMV-SË
Keqpërdorimi i pozitës dhe autoritetit zyrtar	6 vjet	Së paku 5 vjet	1 - 5 vjet
Përvetësimi, shpërdorimi dhe devijimi tjetër i pronës nga një zyrtar publik	8 vjet	Së paku 5 vjet	Nuk parashihet dënim

## Parashkrimi i keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar dhe i përvetësimit të pronës publike

Në shtetet anëtare të BE-së, periudha e parashkrimit të krimeve që kanë të bëjnë me keqpërdorimin e pozitës dhe autoritetit zyrtar është rreth 11 vjet. KE propozon që kjo periudhë të jetë së paku 10 vjet në të gjitha shtetet anëtare.

Parashkrimi pas 5 viteve i paraparë në kodin e ri penal të Maqedonisë së Veriut bie ndesh me praktikën evropiane dhe direktivën e re për luftimin e korrupsionit.

Momentalisht në BE, periudha e parashkrimit të krimeve që kanë të bëjnë me përvetësimin, shpërdorimin dhe devijimin tjetër të pronës publike është rreth 13 vjet. KE propozon që kjo periudhë të jetë së paku 10 vjet në të gjitha shtetet anëtare.

Nga kjo është e qartë se heqja e këtij krimi nga kodi i ri penal i RMV-së është në kundërshtim të hapur me legjislacionin evropian dhe thellësisht anti evropiane.

WWW.IPP-ARBENXHAFERI.ORG

### Parashkrimi i keqpërdorimit të autoritetit zyrtar dhe përvetësimit të pronës publike BE vs. Maqedoni e Veriut

KRIMI	PERIUDHA MESATARE E PARASHKRIMIT TË KRIMEVE E PARAPARË ME LIGJ NË SHTETET ANËTARE TË BE-SË	PERIUDHA E PARASHKRIMIT SIPAS DIREKTIVËS EVROPIANE PËR LUFTIMIN E KORRUPSIONIT	PERIUDHA E PARASHKRIMIT RMV SIPAS KODIT PENAL TË RMV-SË
Keqpërdorimi i pozitës dhe autoritetit zyrtar	11 vjet	Së paku 10 vjet	5 vjet
Përvetësimi, shpërdorimi dhe devijimi tjetër i pronës nga një zyrtar publik	13 vjet	Së paku 10 vjet	Nuk parashihet dënim



## KONKLUZION

Kodi i ri penal i Maqedonisë së Veriut ka ulur dënimet e parapara për keqpërdorimin e pozitës dhe autoritetit zyrtar, për të punuarit e pandërgjegjshëm në shërbim, si dhe për bashkëveprimin kriminal. Rrjedhimisht, sipas dispozitës që rregullon parashkrimin, është përshpejtuar vjetërsimi i këtyre veprave penale. Përveç kësaj, është shfuqizuar dënimi për shpërdorimin e pozitës dhe kompetencave zyrtare gjatë prokurimit publik ose në dëm të mjeteve publike.

Ndikimi i ndryshimit të neneve 353, 353-v dhe 394 në luftimin e krimit dhe të korrupsionit do të jetë jashtëzakonisht i dëmshëm për dekada me radhë. Dënimet në këto lëndë penale do të jenë më të vogla dhe shumë krime do të parashkruhen më shpejt, duke pamundësuar ndekjen penale ose vuajtjen e dënimit. Andaj, ekziston rreziku se pas këtyre ndryshimeve, pandëshkueshmëria do të kthehet në normë në një sistem edhe ashtu jo efektiv në ndjekjen e krimit dhe korrupsionit.

Skandali më i madh i këtyre ndryshimeve qëndron në abuzimin e procedurës së flamurit evropian që mundëson procedurë të shkurtuar për ligjet që synojnë për afrimin e legjislacionit vendor me të drejtën evropiane. Përdorimi i flamurit evropian është arsyetuar nga qeveria por, në esencë, ndryshimi i neneve 353, 353-v dhe 394 është anti evropian dhe në kundërshtim me përpjekjet e institucioneve të BE-së për të luftuar korrupsionin, veçanërisht me praktikën evropiane dhe me direktivën e re evropiane për luftimin e korrupsionit.

Veçanërisht anti evropian është dekriminalizimi i përvetësimit apo shpërdorimit të burimeve publike, krim për të cilin KE kërkon nga shtetet anëtare dënim me burg prej më së paku 5 vjet. Njësoj ani evropian është edhe vjetërsimi më i shpejtë i krimeve që kanë të bëjnë me korrupsionin të cilat tani në Maqedoninë e Veriut do të parashkruhen të gjitha për 3 deri në 5 vjet, ndërsa mesatarja evropiane është 11-13 vjet dhe KE kërkon nga shtetet anëtare që parashkrimi i tyre të jetë së paku 10 vjet.

Andaj, është e qartë se kodi i ri penal bie ndesh me obligimet e Maqedonisë së Veriut si shtet kandidat për anëtarësim në BE. Nga Maqedonia e Veriut kërkohen reforma që forcojnë shtetin e së drejtës dhe përshpejtojnë luftimin e krimit dhe korrupsionit, jo ndryshime laksiste që e largojnë edhe më tej vendin nga normat evropiane. Herët apo vonë, nenet 353, 353-v dhe 394 do të duhet të ndryshohen sërish për të garantuar përputhjen e kodit penal të vendut me direktivën evropiane kundër korrupsionit, duke rritur dënimet dhe afatet e parashkrimit për krimet në fjalë. Por dëmi tanimë i bërë, në mënyrë krejt ironike përmes pazareve politike në emër të integritetit evropian, mund të jetë i pariparueshëm sepse lufta kundër korrupsionit është shndërruar në farsë.

**Instituti për Politika Publike Arbën Xhaferi**

Tel: +389 2 522 2922

E-mail: [info@ipp-arbenxhaferi.org](mailto:info@ipp-arbenxhaferi.org)

Web: [www.ipp-arbenxhaferi.org](http://www.ipp-arbenxhaferi.org)

Tetovska 33/2/7  
1000 Shkup  
Maqedonia e Veriut

**Ndryshimi i Kodit Penal:  
anti evropian dhe i dëmshëm në luftën kundër korrupsionit**

Shtator 2023